

Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 413/01-15954
Data/Datum 21.06.2021

Gjakovë/Djakovica-Gjakova



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



MARRËVESHJE ME PARTICIPIM
për projektin “vendosja e pllakave në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve si dhe punimi i mureve të lapidarit në fshatin Hereq K. Gjakovë”

E përpiluar me datën 16.06.2021 në mes të:

1. Komunës së Gjakovës – të cilën e përfaqëson Ardian Gjini, Kryetari i Komunës së Gjakovës
2. Komuniteti i fshatit Hereq – të cilin e përfaqëson z. Shkelzen Alijaj

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është realizimi i projektit “Vendosja e pllakave në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve si dhe punimi i mureve të lapidarit në fshatin Hereq K. Gjakovë”.

Neni 2

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i komunitetit për realizimin e projektit “Vendosja e pllakave në varret e Dëshmorëve dhe Martirëve si dhe punimi i mureve të lapidarit në fshatin Hereq, Gjakovë”, sipas kërkesës së komunitetit me numër 01-512/01-14664 e datës 10.06.2021, në bashkëfinancim me Komunën e Gjakovës si participues kryesor e këtij projekti.

Neni 3

Vlera e përgjithshme e mjeteve që duke grumbulluar nga participimi i komunitetit dhe i Komunës së Gjakovës për realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje është vlera e përgjithshme sipas paramasa dhe parallogaria prej 19,399.20€.



Neni 4

Vlera e mjeteve që do të siguroj komuniteti është 2,500.00€ (dy mijë e pesqind euro), ndërsa pjesën tjetër e do të sigurohet nga Komuna e Gjakovës.

Neni 5

Vlera e mjeteve që do të siguroj komuniteti sipas nenit 4 të kësaj marrëveshje do të kalojnë në llogari e Komunës, pas kalimit të mjeteve në llogarin e Komunës, implimentimin dhe realizimin e projektit e merr përsipër Komuna e Gjakovës.

Neni 6

Pas zotimit të mjeteve realizimi i këtij projekti do të bëhet përmes procedurës së rregullt të prokurimit, që do t'i zhvilloj Komuna e Gjakovës.

Neni 7

Ekzekutimi i kësaj marrëveshje do të bëhet në mbikëqyrje të menaxherit të projektit dhe komunitetit të fshatit.

Neni 8

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjta do të realizohet me përmbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

Neni 9

Në rast të çdo mosmarrëveshje palët do të përpiqen që të gjejnë zgjidhen në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 10

E përpiluar në katër (4) kopje identike, prej të cilave nga 2 kopje i marrin palët nënshkruese.


PALËT E MARRËVESHJES

Komuna e Gjakovës


Ardian Gjini



Përfaqësuesi i Komunitetit


Shkelzen Alijaj